



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 203, datë 03.06.2022**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika dhe Murat Lleshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” parashikuar në nenin 79/c të Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Vjedhje me dhunë” më shumë se një herë; Akuza: Neni 139 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Blerta Marku (Çibuku) dhe Gjergji Baçi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: Plagosje e rëndë me dashje parashikuar në nenin 88/2 të Kodit Penal.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Artan Jahollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur {...}, etj.; Objekti: Njohje pavërtetësie dokumenti, etj.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Arjeta Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 140-25 i Kodit Penal.

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Etleva Gjamo (relatore), Sokol Ibi dhe Ligoraq Toshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: Detyrimin e të paditurit Komuna Picar të përmbushë detyrimet në bazë të nenit 4 të kontratës së sipërmarrjes datë 31.012.2012 të lidhur midis palëve. Detyrimin e të paditurit {...} të paguajë ½ e vlerës së kontratës së sipërmarrjes datë 31.12.2012 të lidhur midis palëve.

### **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri (relatore), Emona Muçi dhe Alma Ahmeti, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Ndihmë për kalimin të paligjshëm të kufirit”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Marsela Dervishi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Viktima: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale të marrëdhënieve me dhunë me të rritura, të mbetura në tentativë.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Marsela Dervishi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje”; Viktima e veprës penale: {...}.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Emona Muçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i monucionit”, “Kultivimi i narkotikëve”.

5. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Marsela Dervishi (relatore), Emona Muçi dhe Alma Ahmeti, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale: Vjedhje me dhunë, Plagosje e lehtë me dashje, Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta; Viktima: {...}, {...}.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë, Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë sportive”.

7. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornella Naqellari dhe Elona Mihali, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Ndhimë për kalimin të paligjshëm të kufijëve, Mosbindje ndaj urdhërit të policisë së rendit publik, Prodhimin dhe shitje të narkotikëve.

8. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padi të: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Detyrim dëmshpërblim page.

9. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Mihali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padi të: {...}; Të paditur: {...}; Objekti: Njohje pavërtetësi shënimesh.

10. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornella Naqellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padi të: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: Shpërblim dëmi shëndetësor, pasuror dhe jopasuror, etj.

11. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornella Naqellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padi të: {...}, etj.; I paditur: {...}; Person i tretë: {...}, {...}; Objekti: Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror.

## **GJYKATA E APELIT VLORE**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}; Akuza: Neni 248 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: {...} Fier; Viktima: {...}; Objekti: Gjykimi i të pandehurit {...}; Akuza: “Kundërshtimit dhe goditjes së gjyqtarit”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi (relatore), Dritan Hasani dhe Arta Duka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës: {...}, {...}; I paditur: {...}; Objekti: Shpërblim dëmi.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/1, etj, të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 108/a/2 i Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, etj.; Objekti: Dërgimi i çështjes në gjyq.

### **GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal” Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**